

**RAPORT
NDIKIMI I KUFIZIMEVE BANKARE
TEK OJQ-TË NË KOSOVË**





RAPORT NDIKIMI I KUFIZIMEVE BANKARE TEK OJQ-TË NË KOSOVË



“Ky botim është financuar tërësisht nga Qeveria e Suedisë. Qeveria e Suedisë jo domosdoshmërisht ndan mendimet e shprehura këtu brenda. Autori mban përgjegjësinë për përmbajtjen.”

“Ky dokument u hartua si pjesë e projektit “Ndihma teknike për asistencën për Kosovën”, e menaxhuar nga European Center for Not-for-Profit Law Stichting (ECNL). Projekti është bërë e mundur nga International Center for Not-for-Profit Law (ICNL) përmes Civic Space Initiative”

PËRMBAJTJA

7	HYRJA
8	METODOLOGJIA
8	PROBLEMET NË HAPJEN E LLOGARIVE BANKARE NGA ANA E OJQ-VE
13	REKOMANDIMET
14	ANEX

HYRJE

Liria e Asociimit është e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, respektivisht me nenin 44¹. Liria e asociimit përfshinë të drejtën e secilit person për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. Të drejtën për qasje në shërbime financiare ua mundëson edhe Ligji për Liri të Asociimit² më konkretisht Neni 10 Liria për të kërkuar, pranuar dhe përdorur burimet, ku thotë: OJQ ka të drejtë për të kërkuar, pranuar dhe përdorur burime financiare, materiale e njerëzore, qoftë vendore, të vendit të huaj apo ndërkombëtare, për realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të saj. 2. Ndalohet kufizimi, apo bllokimi i qasjes së OJQ-së në burimet në bazë të përkatësisë kombëtare apo të vendit të origjinës së burimit, si dhe stigmatizimi i atyre që pranojnë këto burime.

Po ashtu tek LIGJI NR. 06/L- 043 PËR LIRINË E ASOCIIMIT NË ORGANIZATA JOQEVERITARE me nenin 23 është e rregulluar edhe përfaqësuesi i autorizuar. Ky nen thotë: Personi i autorizuar i organizatës është përgjegjës për hapjen dhe administrimin e llogarisë bankare të OJQ-së, ndërsa Neni 36 Transaksionet financiare të OJQ-së thotë se të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e OJQ-së, kryhen nëpërmjet institucioneve financiare të licencuara nga BQK në llogaritë bankare të hapura në emër të OJQ-së, përveç përjashtimeve të lejuara me legjislacionin në fuqi.

Në vitet e fundit në Kosovë qasja në shërbime bankare nga ana e OJQ-ve është vështirësuar nga bankat komerciale të licencuara nga BQK. Disa nga problemet që OJQ-të po ballafaqohen janë:

- Mbyllja e llogarive bankare pa paralajmërim;
- Kërkesat që themeluesit e OJQ-së të jenë prezent në hapje të llogarisë bankare apo prezantimi i dokumenteve identifikues të themeluesve të OJQ-së duke mos i njohur organet qeverisëse të OJQ-ve siç janë Kuvendi i Anëtarëve dhe Bordi, ku jo domosdoshmërisht themeluesit mund të kenë rol qeverisës në organizatë.
- Ngritja e shumave për pagesë për mirëmbajtje të llogarive vetëm për OJQ-të në shuma të pa përballueshme.

Pengesat e tilla që OJQ-të kanë në qasje në shërbime bankare përveç që e cenojnë të drejtën bazike për liri të asociimit të mbrojtur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kufizimet e tilla rrezikojnë që OJQ-të të kenë qasje të kufizuara në burime financiare duke vështirësuar arritjen e misioneve të tyre në dobi të përgjithshme. Po ashtu qasja e vështirësuar në këto shërbime mund të rris rrezikun e përdorimit të formave alternative të qarkullimit me mjete financiare gjë që bije ndesh me legjislacionin e Kosovës dhe rritë mundësinë e keqpërdorimeve.

Të dy Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ndërsa kundërshton terrorizmin, dhe Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e lirisë së tubimit paqësor dhe lirisë së asociimit kanë theksuar se përjashtimi financiar bie brenda të drejtave të tyre themelore dhe pohoi se mohimi i qasjes në shërbime financiare për shoqërinë civile prek një varg të drejtash të njeriut, përfshirë të drejtën e lirisë së asociimit.

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

² Ligji NR. 06/L- 043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare në Republikën e Kosovës 2019 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>

METODOLOGJIA

Duke parë problemet e tilla që OJQ-të po ballafaqohen në qasjen në shërbimet bankare në Kosovë CiviKos ka realizuar një hulumtim me disa organizata të shoqërisë civile që veprojnë në Kosovë për të parë natyrën e problemeve që OJQ-të po ballafaqohen në hapje dhe mirëmbajtje të llogarive bankare. Këtë pyetësor e kanë plotësuar 21 organizata të shoqërisë civile.

Pyetësori me 7 pyetje iu është dërguar online organizatave anëtare të CiviKos (rreth 250 organizata), dhe atyre jo-anëtare në CiviKos: Pyetjet janë përpiluar për të identifikuar problemet në hapjen dhe mirëmbajtjen e llogarive bankare. Pas përfundimit të hulumtimit janë grumbulluar dhe përpunuar rezultatet e hulumtimit.

Ky është një studim fillestar eksplorues për të ndihmuar CiviKos të identifikojë sfidat e OJQ-ve në hapjen dhe mbajtjen e llogarive të tyre bankare. Rezultatet e anketës u mblodhën dhe u përpunuan nga ekipi i CiviKos. Ajo u pasua nga takime dhe grupe të fokusit me pesë OJQ për të diskutuar më tej këtë çështje.

PROBLEMET NË HAPJEN E LLOGARIVE BANKARE NGA ANA E OJQ-ve

Dokumentet që kërkohen për hapje të llogarive bankare për OJQ-të në Kosovë

Lista e dokumenteve që bankat komerciale ju kërkojnë OJQ-ve për hapjen e llogarive bankare përveç dokumenteve bazike siç janë certifikata e regjistrimit, numrit fiskal dhe letër-konfirmimi për personin e autorizuar, shumica e bankave OJQ-ve ju kërkojnë edhe prezencën e të gjithë themeluesve të OJQ-së, nënshkrimet e tyre, apo kopjet e letërnjoftimeve të tyre, Statutin e OJQ-së, aktin themelues e deri tek lista e stafit.

Për këtë CiviKos i ka pyetur se:

I. Cilat janë dokumentet që ju kanë kërkuar për hapje të llogarisë bankare?

OJQ-të janë përgjigjur kështu:

76 % e responentëve janë përgjigjur se bankat iu kanë kërkuar këto dokumente:


- Letërnjoftimi, certifikata e numrit fiskal, certifikata e regjistrimit, kontrata e donatorit për projekt, certifikata e biznesit, dokumenti për përfituesit e organizatës, deklarata origjinale e nënshkruar nga 3 themeluesit për autorizim të drejtorit ekzekutiv dhe koordinatores së zyrës; Statuti, personi i autorizuar, faturë e rrymës;
- Aktin e themelimit, vërtetim nga Ministria e Administratës Publike, kopje të letërnjoftimeve të themeluesve, autorizim nga themeluesit, vula;
- Vendimin e Kuvendit për emërim të drejtorit;

Ndërsa 24 % e respondentëve kanë thënë se iu janë kërkuar këto dokumente :

- Certifikata e numrit fiskal, letërnjoftimi i personit legal, si dhe të personit të autorizuar;
- Listat e stafit, listat e bordit, listën e personave të autorizuar;
- Formulari për identifikimin e personit të ekspozuar politikisht (PEP) për themeluesit e organizatës dhe personat e autorizuar, formulari mbi burimin e prejardhjes së fondeve për themeluesit e organizatës dhe personat e autorizuar, nënshkrimi i formave nga BQK nga të gjithë anëtarët e bordit.

2. Në pyetjen e dytë se: A ju kanë kërkuar nga banka që të përditësoni të dhënat e Organizatës në bankë?

71 % janë përgjigjur me PO, dhe 29 % janë përgjigjur me JO



2.1 Në pyetjen se nëse ju kanë kërkuar përditësimin e të dhënave, cilat kanë qenë kërkesat e bankës?

52 % e respondentëve janë përgjigjur se iu janë kërkuar këto informata dhe dokumente:


- Adresa e saktë e dëshmuar me ndonjë faturë të shërbimeve publike, përditësimi i plotë i shënimeve të personave të autorizuar, plotësimi i disa dokumenteve që nuk janë kërkuar në fillim kur janë hapur llogaritë.
- Konfirmim që ka, apo nuk ka ndryshim në informata p.sh. adresa, numri i kontaktit e të ngjashme;

48 % e respondentëve janë përgjigjur se iu janë kërkuar këto dokumente:

- Certifikatën e regjistrimit, letër-konfirmimi (më i ri se 6 javë), statuti, letërnjoftimi apo pasaporta valide (e pronarit dhe personave të autorizuar), të gjithë themeluesit e organizatës të jenë prezent në bankë për të nënshkruar;
 - Certifikata e regjistrimit të organizatës, konfirmimin e OJQ-së, statuti i OJQ-së, kopje e letërnjoftimit të themelueseve të organizatës, kopje e letërnjoftimit të personave të autorizuar të organizatës, formulari për identifikimin e personit të ekspozuar politikisht (PEP) për themeluesin e organizatës dhe personat e autorizuar, formulari mbi burimin e prejardhjes së fondeve për themeluesin e organizatës dhe personat e autorizuar;
-

3. Në pyetjen se: A ju është bllokuar llogaria e bankës me ose pa paralajmërim?

29 % janë përgjigjur me Po pa paralajmërim, 6 % po me paralajmërim me shkrim dhe 6 % po me paralajmërim me gojë, dhe është kërkuar prezenca e themeluesve të OJQ-së (Kanë kërkuar prezencën e një themeluesi edhe pse ai jeton në Francë)



Dështimi i sjelljes së themeluesve të OJQ-së në bankë apo sigurimi i nënshkrimeve të tyre apo kopjeve të letërnjoftimeve pavarësisht se themeluesit në OJQ nuk kanë pasur asnjë rol në menaxhim të OJQ-së ka qar në bllokimin e llogarive bankare. Bllokimi i llogarive bankare nga bankat për disa OJQ përveç mos-mundësisë së operimit me mjete financiare ka qar edhe në vonesa në pagesa për tatime, vonesa të cilat me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës shoqërohen me ndëshkime për OJQ-të.

4. Për te parë se si OJQ-të i kanë menaxhuar këto situata ne i kemi pyetue se: Nëse ju është bllokuar llogaria e bankës, çfarë veprime keni ndërmarrë për ta zhblokuar?


- 6% e OJQ-ve që janë përgjigjur në pyetësorë janë përgjigjur se ata janë larguar nga banka;
- 88 % e OJQ-ve që janë përgjigjur në pyetësorë janë përgjigjur se ata kanë kaluar nëpër procedura të vështira me bankën, vecanërisht për të shpjeguar se themeluesit e OJQ-së nuk kanë rol menaxhues në organizatë, por në fund janë detyruar të sjellin nënshkrimet e themeluesve të organizatës për të zhblokuar llogarinë bankare të OJQ-së.
- 6% e OJQ-ve që janë përgjigjur në pyetësorë janë përgjigjur se janë detyruar që të ndryshojnë themeluesit e organizatës dhe të sjellin statutin e ri, të marrin nënshkrimet e “themeluesve të rinj” edhe pse kjo është në kundërshtim me Ligjin për Liri të Asocimit në Kosovë, por banka nuk ju ka dhënë ndonjë opsion tjetër.

Përveç qasjes së vështirësuar në hapje të llogarive bankare, dhe bllokimit të llogarive , vështirësi tjetër e identifikuar që OJQ-të ballafaqohen me bankat komerciale në Kosovë është rritja e pagesës për mirëmbajtje të llogarive ku vetëm në periudhën 2018-2019 në shumicën e bankave çmimi për mirëmbajtje të llogarive bankare për OJQ është trefishuar, ose dhjetëfishuar. Aktualisht në Kosovë varësisht se në cilën bankë OJQ-të i kanë llogaritë e tyre bankare çmimet për mirëmbajtje mujore variojnë nga 2-30 euro për muaj.

Për të parë se sa paguajnë OJQ-të për mirëmbajtje mujore i kemi pyetur se:

5. Sa është pagesa mujore që paguani për mirëmbajtje të llogarisë bankare?

33% janë përgjigjur 2-10 euro për muaj, 62 % janë përgjigjur-10-20 euro për muaj dhe 5 % janë përgjigjur mbi 20 euro për muaj.



Në fund kemi kërkuar nga responentët që të ndajnë problemet/shqetësimet e tyre në raport me bankat komerciale ku iu kemi bërë pyetjen:

6. Ju lutem shfrytëzoni këtë hapësirë të ndani me ne problemet që i keni hasur në raport me bankat komerciale ku i keni llogaritë e juaja bankare, ata janë përgjigjur si në vijim:

- Normat e larta të mirëmbajtjes dhe të transfereve si dhe pritjet e stërzgjatura në sportelet e tyre, mos-professionalizimi gjatë thirrjeve për të rregulluar ndonjë problem, si dhe tarifat e larta për shërbime për nevojat e organizatës, nuk janë unik në dhënie të informatave që shkakton konfuzion.
- Pagesat për OJQ janë shumë të larta, dhe më të larta se bizneset fitim-prurëse, probleme me ndërrimin e personave të autorizuar, probleme me qasje në e-banking edhe pse paguajmë për përdorimin e tij,
- Kemi bërë kërkesë për hapje të llogarisë në një bankë, edhe pse i kemi dorëzuar të gjitha dokumentet që i kanë kërkuar nuk na është hapur llogaria me arsyetimin se OJQ-të po shihen si të dyshimta nga stafi i lartë menaxhues dhe nuk kanë marr asnjë vendim.
- Problem kryesor qëndroni në faktin se bankat gjithmonë kërkojnë prezencën e themeluesve,

edhe pse me statut është i emëruar personi i autorizuar për kontakt me bankat dhe institucionet. Mandati i themeluesve të organizatës është ta themelojnë atë dhe nuk është e domosdoshme që ata të jenë gjithmonë anëtarë. Fakti që ata nuk janë anëtarë, është shumë e bezdisshme dhe e vështirë që gjithmonë për çdo veprim në bankë të kërkohet prezenca e tyre. Bankat duhet ta njohin si legjitim personin e autorizuar me statut, jo të kërkojnë themeluesit e organizatës sepse ata mund të mos kenë kohë të mjaftueshme, mund të jenë jashtë shtetit apo edhe mund të vdesin. Kjo çështje na ka preokupuar që nga themelimi i organizatës në vitin 2013;

- Bllokimi nga njëra bankë e llogarisë pa paralajmërim na ka shkaktuar probleme me pagesa, edhe detyrimi nga banka për ti tërhequr paratë në cash, për t'i transferuar në bankën tjetër, por pas një ankese edhe mos pajtim për tërheqje cash, banka ka transferuar të gjitha mjetet në bankën tjetër edhe na ka mbyllur të gjitha llogaritë e organizatës;
- Besojmë që pagesa mujore për mirëmbajtje prej 20 eurove është e lartë posaçërisht për organizata që si në rastin tonë që operojmë përmes projekteve të vogla;
- Në të gjitha bankat komerciale në Kosovë, OJQ-të trajtohen si korporata apo biznese, dhe hapja e llogarisë bankare mund të zgjasë edhe deri në 2 javë . Po ashtu në njërin nga bankat kemi tentuar para një kohe të hapim një llogari për organizatë por zyrtarët e kësaj banke na informuan që për OJQ-të nuk është e mundur të hapet llogaria. Këtë veprim e konsiderojmë si të pa ligjshëm dhe diskriminues ndaj klientëve;
- Humbja e kohës gjatë procesit të ndryshimit të personave të autorizuar, probleme teknike me e-banking (ngadalësim, ngrirje etj), pagesa shumë të larta, për mirëmbajtje dhe për pagesa ndërkombëtare, mungesa e agjentit bankar për OJQ-të;
- Në përgjithësi, nuk ka fleksibilitet dhe shërbime të avancuara. Po ashtu, bllokimi i llogarisë pa paralajmërim ka shkaktuar dëme të mëdha në punët dhe aktivitetet ditore. Konsideruar që jemi OJQ me status të përfitimit publik, trajtimi i njëjtë sikurse bizneset e vogla apo të mesme nuk është i drejtë. Duhet të ketë çmimore të veçantë për OJQ-të që konsideron burimin e të hyrave dhe qëllimin e atyre të hyrave. OJQ-të raportojnë çdo mars të vitit në zyrën e OJQ-ve përfshirë raportet narrative dhe ato financiare, andaj BQK dhe bankat komerciale mund të koordinohen me zyrën e OJQ-ve në konfirmimin e ekzistencës së një organizate dhe të mos na ngarkojnë me procese burokratike të panevojshme. Një tjetër problematikë me bankat komerciale është mospranimi i nënshkrimit elektronik, gjë që është e rregulluar tashmë me posedimin e letërnjoftimeve biometrike.
- Gjatë aplikimit për hapjen e nën-llogarive të reja të organizatës janë kërkuar më shumë dokumente dhe është kërkuar nga ne që të presim një kohë nga banka për të na treguar se a kemi të drejtë të hapim këto nën-llogari. Kjo ka shkaktuar vonesë në disa aktivitete të organizatës tonë.

REKOMANDIME

Rekomandime të përgjithshme

Të gjitha institucionet përgjegjëse duhet të angazhohen në dialog konstruktiv dhe sistematik për lehtësimin e problemeve që OJQ-të po ballafaqohen me bankat komerciale.

Për Bankën Qendrore

- BQK të përditësoj RREGULLOREN PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIIMIT TË TERRORIZMIT³ dhe të specifikohet se personi përgjegjës për hapje dhe mirëmbajtje të llogarive bankare nga ana e OJQ-ve të jetë personi i autorizuar i organizatës siç e parasheh Ligji për Liri të Asociimit në Republikën e Kosovës, dhe organet tjera qeverisëse varësisht nga forma e regjistrimit të OJQ-ve .
- Banka Qendrore duhet të sigurojë udhëzime për bankat komerciale rreth kujdesit të shtuar për OJQ-të.
- Banka Qendrore duhet të sigurojë harmonizimin e informacionit që bankat e ndryshme komerciale kërkojnë për të siguruar barazi në mënyrë që të mos ketë një trajtim të padrejtë për OJQ-të.
- Banka Qendrore duhet të sigurojë harmonizimin e informacionit që bankat e ndryshme komerciale kërkojnë për të siguruar barazi në mënyrë që të mos ketë një trajtim të padrejtë për OJQ-të.

Për Bankat Komerciale

- Bankat komerciale duhet të kërkojnë informacione që janë të përshtatura për sektorin e OJQ-ve , dhe nuk duhet të trajtohen si ndërmarrje të vogla ose të mesme. Me rëndësi, bankat komerciale nuk duhet të kërkojnë praninë e themeluesve të organizatës duke marrë parasysh që themeluesit jo domosdoshmërisht kanë një rol udhëheqës / drejtues në organizatë, dhe ata zakonisht janë vetëm pjesë e historisë së organizatës.
- Bankat komerciale duhet të përdorin bazën e të dhënave të Departamentit për Regjistrimin e OJQ-ve për të verifikuar të dhënat e organizatës.
- Bankat komerciale nuk duhet të pezullojnë llogaritë e OJQ-ve pa njoftim paraprak duke u shkaktuar atyre vështirësi në punën e tyre të përditshme.

Për Qeverinë e Republikës të Kosovës:

- Qeveria duhet të monitorojë Bankën Qendrore dhe Bankat Komerciale për të siguruar që OJQ-të të kenë qasje në shërbimet financiare dhe hapësira e tyre vepruese të mos pengohet.
- Ne rekomandojmë të konsideroni krijimin e një roli të pavarur mbikqyrës për t'u marrë me çështjen e qasjes në shërbime bankare me të cilat përballen OJQ-të.

Për OJQ-të:

- Ne rekomandojmë që OJQ-të të vazhdojnë të ngrisin vetëdijen për sfidat me të cilat përballen në qasjen në shërbime bankare.
- OJQ-të duhet të jenë të vetëdijshme për përgjegjësitë e tyre në lidhje me politikat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

³ https://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/english/11-BQK%20-%20ENG%20-%20Rregullorja%20per%20parandalimin%20e%20pastrimit%20te%20parave.pdf

ANEX

Pyetësor

1. Cilat janë dokumentet që ju kanë kërkuar për hapje të llogarisë bankare?
2. A ju kanë kërkuar nga banka që të përditësoni të dhënat e Organizatës në bankë?
 - 2.1 Nëse Po cilat kanë qenë kërkesat e bankës?
3. A ju është bllokuar llogaria e bankës me ose pa paralajmërim?
 - 3.1 Nëse ju është bllokuar llogaria e bankës, çfarë veprime keni ndërmarrë për ta zhbllokuar?
4. Sa është pagesa mujore që paguani për mirëmbajtje të llogarisë bankare?
5. Ju lutem shfrytëzoni këtë hapësirë të ndani me ne problemet që i keni hasur në raport me bankat komerciale ku i keni llogaritë e juaja bankare.

